



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
MINISTRI

Nr. 129131 Prot.
3

Tiranë, më 6 / 10 / 2025

URDHËR

Nr. 125, Datë 6 / 10 / 2025

PËR

“MIRATIMIN E FATURË-ARKËTIMIT”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”

URDHËROJ:

1. Përdorimin e dokumentit “Faturë-Arkëtimi” sipas modelit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe miratohet me këtë urdhër.
2. Faturë-Arkëtimi hartohet vetëm sipas këtij formati nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme që realizojnë të ardhura jo tatimore dhe taksa lokale nga klientë, persona fizikë ose juridikë.
3. Institucioni plotëson në mënyrë të plotë dhe të saktë:
 - a. Emërtimin e bankës së nivelit të dytë ku adresohet;
 - b. Emërtimin e institucionit përfitues,
 - c. NIPT-in dhe kodin e institucionit përfitues,
 - d. Emrin e klientit dhe NID/NIPT-in e klientit,
 - e. Numrin e aplikimit (nëse ka),
 - f. Emërtimin dhe kodin e degës së Thesarit ku vepron,
 - g. Përshkrimin e të ardhurave që pritet të arkëtohen,
 - h. Kodin shtatëshifror të llogarisë ekonomike të të ardhurave që pritet të arkëtohen,
 - i. Shumën e të ardhurave që pritet të arkëtohen.

4. Për arkëtimin e të ardhurave klientët paraqiten fillimisht në institucion për të tërhequr Faturë-Arkëtimin ose e shkarkojnë atë nga faqja e internetit e ministrive apo institucioneve të linjës, si dhe nga faqja e internetit e Ministrisë së Financave.

5. Pasi fatura e plotësuar nënshkruhet nga përfaqësuesi i institucionit dhe klienti, një kopje e saj mbetet në institucion dhe një kopje i jepet klientit për kryerjen e veprimeve në Bankën e Nivelit të Dytë të adresuar.

6. Banka e Nivelit të Dytë pranon arkëtimet e të ardhurave jo tatimore nga klientët (persona fizikë ose juridikë) vetëm nëse paraqitet "Faturë-Arkëtimi". Pasi verifikon saktësinë e faturës, banka pranon arkëtimin dhe regjistron të ardhurën në kutizat përkatëse në cepin e djathtë të faturës.


7. Ngarkohen të gjitha institucionet buxhetore, ministritë dhe institucionet e tjera qendrore të linjës, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit dhe Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit pranë Ministrisë së Financave, për zbatimin e këtij urdhri.

8. Urdhri Nr.-95, datë 11.11.2009 "Për miratimin e Faturës për Arkëtim" shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Petrit Malaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
(Emërtimi i Institucionit)

FATURË PËR ARKËTIM

Nr. _____ më: ____ / ____ /20 ____

BANKËS _____

Me anë të kësaj fature kërkojmë që Banka e Nivelit të Dytë të pranojë nga klientë (persona / persona fizik / persona juridik) arkëtime të të ardhurave, për llogari të institucionit tonë, me emërtime, kode dhe shuma si më poshtë:

Emri i institucionit përfitues: _____

NIPT: XXXXXXXXXXXX

Kodi i institucioni përfitues: XXXXXXXX

Kodi i degës së Thesarit: XXXX

Emër Mbiemër i klientit: _____

Nr. Personal i Identifikimi (NID) / NIPT: _____

Nr. i aplikimit: _____

Nr.	Përshkrimi i të ardhurave		Shuma e arkëtimit (Në lekë)
	Emërtimi	Kodi i llogarisë ekonomike	
1	Të ardhura nga	7XXXXXXX	X
2			
	TOTALI		X

INSTITUCIONI:

(Emër Mbiemër)

KLIENTI:

(Emër Mbiemër)

Adresa: _____

Kontakti: _____

(Adresa e Institucionit)